

EC

MA ND RYSHË



SIGURIA NË TRAFIK

GUSHT

2020

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



EC Ma Ndryshe


SIGURIA NË TRAFIK

Autor dhe botues: EC Ma ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Gusht, 2020

HYRJE



Pasiguria në trafikun rrugor është një nga problemet kryesore e me ndikim të madh për shëndetin publik dhe zhvillim të shoqërive në mbarë botën, e me një theks të veçantë në Kosovë. Pakujdesia e shoferëve, shpejtësia e lartë e drejtimit të automjetit, parregullsitë teknike të mjetit tradicionalisht janë konsideruar si shkaktarë kryesorë të aksidenteve rrugore. Megjithatë edhe ndikimi i elementeve rrugore si amortizimet, sinjalizimi e ndriçimi luajnë një rol jo të vogël në shkaktimin e këtyre aksidenteve.¹

Sipas statistikave të numrit të aksidenteve me pasoja fatale në trafikun rrugor në Kosovë, përqindja më e lartë e aksidenteve është si në vijim:




34% e aksidenteve fatale të trafikut rrugor kanë ndodhur në rrugë nacionale (magjistrale).



27% e aksidenteve fatale të trafikut rrugor sipas tipit të aksidentit kanë qenë automjet-këmbësor



28% e aksidenteve fatale të trafikut rrugor kanë ndodhur në intervalin kohor prej orës 18:00 – 22:00.



64% e shkaktarëve të aksidenteve fatale të trafikut rrugor kanë poseduar patentë shofer vendor, pa patentë shofer 26%, ndërsa me patentë shofer të huaj 6%²

Duke e parë me shqetësim këtë çështje, EC Ma Ndryshe ka realizuar një hulumtim me temë “Siguria në trafik” me qytetarët e lagjeve të Prizrenit.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte grumbullimi i informatave në lidhje me sigurinë e lëvizjes së qytetarëve në rrugë dhe hapësira publike. Për të kuptuar se sa janë të kenaqur këta të fundit me gjendjen aktuale të trafikut, EC ka dizajnuar një pyetësor.


Numri total i të anketuarve është 100 persona , prej të cilëve 41 gra dhe 59 burra.

Paraqitja grafike e të dhënave të hulumtimit është në vijim.

¹ <https://bit.ly/3281Ncf>

² <https://bit.ly/34nJBy2>


1. SI E VLERËSONI SIGURINË NË TRAFIK BRENDA QYTETIT TË PRIZRENIT ?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve e vlerësojnë trafikun në qytetin e Prizrenit të sigurtë ose deri diku të sigurtë. Nga kjo përqindje, pjesa më e madhe janë burra ndërkohë që vetëm 36% e grave e ndajnë këtë mendim. Shikuar sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim.


2. SA JENI TË KËNAQUR ME FUNKSIONIMIN E SEMAFORAVE NË QYTETIN TUAJ ?



PËRMBLEDHJE:

Sipas të dhënave të mbledhura, 34% e të anketuarve janë treguar mesatarisht të kënaqur me funksionimin e semaforëve në qytetin e Prizrenit. Vlerësimi sipas gjinisë nuk ka ndonjë diferencë të madhe (30% burra & 39% gra- mesatarisht të kënaqur) kurse sipas moshës të dhënat tregojnë se 55% e të rinjve të moshave 19 -24 janë pak të kënaqur kurse vetëm 5% e të njëjtës grupmoshë e vlerësojnë si shumë mirë funksionimin e semaforëve në qytetin e tyre.


3. SA I SHIHNI TË MJAFTUESHËM POLICËT E SHTRIRË NËPËR RRUGËT E QYTETIT ?



PËRMBLEDHJE:


Shumica e të anketuarve mendojnë se policët e shtrirë nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit janë të mjaftueshme. Prej tyre 42% anketues që kanë të njëtin mendim janë gra kurse 30% burra. Nëse vlerësojmë sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe.

4. A E SHIHNI MË EFEKTIVE VENDOSJEN E KAMERAVE NË LAGJE PËR SHKAQE SIGURIE NË TRAFIK ?



PËRMBLEDHJE:


Shumica ose përndryshe 80% e të anketuarve mendojnë që do të ndiheshin më të sigurt nëse do të vendoseshin kamerat e sigurisë nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit. Derisa vetëm 2% e grave dhe 5% e burrave nuk e shohin të arsyeshme një veprim të tillë. Nëse vlerësojmë sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe.



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve e vlerësojnë shenjëzimin në qytetin e Prizrenit mesatarisht të mirë. Nga kjo përqindje, edhe gratë edhe burrat me një dallim shumë të vogël ndajnë mendime të njëjta. Poashtu shikuar sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim ku vetëm 25-35% të anketuarve sipas pyetësorit dalin jo të kënaqur nga këto shenjëzime.


6. A NDIHENI MË TË SIGURTË NËSE E KALONI RRUGËN PËRGJATË ZEBRAVE ?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve kanë deklaruar se ndihen shumë të sigurt gjatë kalimit të rrugës përgjatë zebrave. Nga kjo përqindje, shikuar sipas gjinisë e moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim.


7. TROTUARET JANË TË UZURPUARA VAZHDIMISHT NGA PARKIMI I VETURAVE.



PËRMBLEDHJE:

60% e të anketuarve pajtohen plotësisht se trotuaret nëpër rrugët e qytetit janë të uzurpuara nga parkimi i veturave. Nga kjo përqindje, pjesa më e madhe janë gratë me 66% ndërkohë që 56% e burrave e ndajnë këtë mendim.


8. SA MENDONI SE JANË TË NEVOJSHME SHTIGJET E BIÇIKLETAVE ?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve e vlerësojnë shumë të nevojshme formimin e shtigjeve të biçikletave nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit. Nga kjo përqindje, pjesa më e madhe janë qytetarët e moshave 19-34 vjeç me 60-65%, kurse shikuar nga gjinia gratë dhe burrat tregojnë një qëndrim të barabartë.


9. SA MENDONI SE NDRIÇIMI PUBLIK ËSHTË NË NIVELIN E DUHUR NËPËR RRUGËT E QYTETIT ?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur me ndriçimin publik në rrugët e qytetit të Prizrenit. Nga kjo përqindje, pjesa më e madhe janë burra me 58% ndërkohë që vetëm 51% e grave e ndajnë këtë mendim. Shikuar sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim përveç që 41% e anketuesve të moshës 35-44 vjeç janë pak të kënaqur, kurse 24% të tyre aspak të kënaqur nga kualiteti i ndriçimit në qytet.


10. NË ÇFARË CILËSIE QËNDROJNË SHENJAT E KOMUNIKACIONIT NË RRUGËT E QYTETIT ?



PËRMBLEDHJE:

Sipas të dhënave të mbledhura del që qytetarët janë të mendimit që shenjat e komunikacionit në rrugët e qytetit të Prizrenit janë të mjaftueshme por janë të dëmtuara. Shikuar sipas gjinisë 25% e të anketuarve burra dhe 49% e tyre gra janë të mendimit se shenjat në rrugët e qytetit të Prizrenit nuk janë të mjaftueshme. Shikuar sipas moshës, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim.


11. A MENDONI SE POLICËT JANË DUKE KONTRIBUAR MJAFTUESHËM PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT NË QYTET?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve e vlerësojnë punën e policëve në rrugët e qytetit të Prizrenit jo të mjaftueshëm. Nga kjo përqindje, shikuar sipas gjinisë, të dhënat nuk tregojnë ndonjë diferencë të madhe në vlerësim, derisa 49% e burrave dhe 42% e grave janë të mendimit të lartëpërmendur. Ndërsa bazuar në mendimin e qytetarëve të grupmoshës 45+ kontributi i policëve në trafikun e qytetit është i mjaftueshëm.


12. A JENI PËRFSHIRË JU SI QYTETAR NDNJËHERË NË DISKUTIME PUBLIKE LIDHUR ME ORGANIZIMIN E TRAFIKUT NË QYTETIN APO PËR RITJEN E SIGURISË NË TRAFIK ?



PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve ose 73% e tyre kanë deklaruar që asnjëherë nuk janë përfshirë si qytetarë në diskutime publike lidhur me organizimin e trafikut në qytetin apo për rritjen e sigurisë në trafik. Nga kjo përqindje 51% janë gra dhe 20% burra. Derisa vetëm 7% e grave kanë deklaruar që shpesh kanë marrë pjesë në diskutime publike rreth çështjes së lartëpërmendur. Shikuar sipas moshës pjesëmarrësit me përqindje më të madhe në diskutime publike kanë dal qytetarët mbi moshën 45 vjeç.

PËRFUNDIME



Nga hulumtimi “Siguria në trafik” mund të konkludohet që në përgjithësi qytetarët e Prizrenit e vlerësojnë trafikun në qytetin e tyre të sigurtë ose deri diku të sigurtë.



Derisa dihet që semaforët janë shumë të rëndësishëm për rregullimin e komunikacionit, sipas qytetarëve të Prizrenit del se ata nuk janë shumë të kënaqur me funksionimin e tyre në qytet, duke u përgjigjur 34% e tyre në opsionin “Pak”, e deri sa në anën tjetër për **40%** të tyre, shqetësim mbetet edhe mungesa e policëve të shtrirë në rrugë.



Duke qenë dëshmitarë se sa e vështirë është ecja në trotuare nga këmbësorët për shkak të uzurpimit të tyre nga veturat, EC ka parë të arsyeshme që edhe njëherë ta paraqes këtë çështje. **60%** e të anketuarve janë pajtuar plotësisht se vështirësohen gjatë ecjes nëpër rrugë të qytetit, duke e ndjerë veten vazhdimisht të rrezikuar.



Një pjesë e qytetarëve kanë filluar që si mjet të lëvizjes t'i përdorin biçikletat si alternativë mbrojtjen e mjedisit, mirëpo shpesh këta po bien ndesh me vendimin e tyre sepse nuk po ju ofrohet hapësirë e lëvizjes nga fakti se sa të mangëta janë shtigjet e biçikletave në rrugët e qytetit të tyre. **55%** e qytetarëve në bazë të hulumtimit, e kanë ngritur si çështje mungesën e hapësirave adekuate për ngasjen e biçikletave.



Duke e ditur se kontributin më të madh në përmirësimin e gjendjes në trafik e japin policët, vetëm 21% e qytetarëve e shohin të mjaftueshëm këtë kontribut nga policët në vendin e tyre.

REKOMANDIME



Vendosja e shtigjeve të biçikletave me ndarje vizuele (me ngjyrë) dhe vendparkingjet:

Biçikleta është mjeti transportues me të cilin destinimet shpesh arrihen shumë më shpejtë sesa me automjete. Prizreni si njëri prej qyteteve që ka strukturë organike urbane me këtë rast edhe rrjet të tillë rrugor ka vështirësi të shumta komunikimi. Ky qytet veçse ka predispozita të shumta për një qytet shembull dhe kështu me shtimin e shtigjeve për çiklistë i shtohet edhe një arsye më shumë për ta vizituar dhe për ta përdorur biçikletën lirshëm.



Njoftime nga institucionet përgjegjëse për thirrje në diskutime publike për përfshirje të të gjitha palëve të interesit:

Pjesëmarrja e publikut është një element kyç për demokracinë e një vendi. Me anë të komunikimit të dyanshëm, në fakt pjesëmarrjes në vendimmarje të të gjitha palëve të interesit ndikon që të shfletohen së bashku shqetësimet, nevojat, vlerat, pritshmëritë dhe problemet që në fund të arrihet një përfundim i favorizuar nga të gjitha palët.



Të rregullohet infrastruktura rrugore, të bëhet mirëmbajtja e rregullt e rrugëve, semaforëve, shenjave të komunikacionit dhe policëve të shtrirë;

Riparim i shenjzimeve rrugore:

Ndër elementet e rregullimit të trafikut janë edhe shenjzimet rrugore të cilat sjellin siguri dhe rend në trafik. Mirëpo përveç ekzistencës së tyre rëndësi të veçantë ka edhe mbikëqyrja dhe në rast nevojë zëvendësimi apo riparimi i tyre. Derisa qytetarët duhet të tregojnë kujdes të veçantë për mosdëmtimin dhe respektimin e tyre, poashtu dhe institucionet përkatëse duhet të ndërmarrin masa për mosrespektim të shenjave dhe poashtu riparim të tyre në rast nevojë nga thyerjet, shlyerjet apo mbulesat nga elemente të ndryshme.



Mbikëqyrja e semaforëve:

Për rregullimin e trafikut nëpër rrugët e qytetit në botë që nga vitet 1800 përdoren dhe semaforët. Respektimi i semaforëve është një nga rregullat kryesore të trafikut. Përndryshe, mund të paraqiten aksidente fatale. Por një çështje tjetër është edhe jofunksionimi i duhur dhe poashtu lënia pas dore e mbikëqyrjes së tyre në raste defekti. Për një siguri më të madhe në trafik dhe për shmangie të aksidenteve duhet të merren masa të dyanshme si nga qytetarët ashtu edhe nga përgjegjësit.



REKOMANDIME



Kufizimi i shpejtësisë përmes policëve të shtrirë:

Tejkalimi i shpejtësisë nga veturat nëpër rrugët e qytetit është një nga problemet që më së shumti ballafaqohen rregulluesit e trafikut. Rrugët e qytetit edhe pse janë të pajisura me shenja të kufizimeve të shpejtësisë, një pjesë dërrmuese e ngasësve nuk i respektojnë ato duke sjellë pasoja të rënda shëndetësore për vete e për shoqërinë por edhe dëme materiale të dyanshme. Vendorsja, mbikëqyrja dhe nëse është nevoja shtimi i sasisë së policëve të shtrirë nëpër rrugët e qytetit ndihmon dukshëm në zvogëlimin e rrezikut që sjellin vozitësit e shpejtë.



Drejtuesit e automjeteve si dhe këmbësorët t'i përmbahen me përpikëri shenjave të komunikacionit:

Mënyra e komunikimit të automjeteve në rrugë bëhet nëpërmjet shenjave të komunikacionit. Mosekzistimi, dëmtimi, shlyerja apo thyerja e tyre mund të bëhet shkaktar që vozitësit të bëjnë gabime të pazëvendësueshme në trafik. Sidomos nëse flitet për lagjet tek të cilat kujdesi i ngasësit duhet të jetë maksimal. Përgjegjësit institucional, vozitësit dhe përndryshe të gjithë qytetarët duhet të shtojnë kujdes për mos dëmtimin e këtyre shenjave dhe në raste dëmtimi zëvendësimin e tyre.



Zhvillimi i një plani për lirim të trotuareve me qëllim që këmbësorëve t'i mundësohet lëvizja e lirë:

Trotuaret janë vende që janë ndërtuar me qëllim që këmbësorëve të ju lehtësohet qarkullimi në një mënyrë më të sigurtë nëpër rrugët e qytetit. Por uzurpimi vazhdimisht i tyre nga ana e veturave e vështirëson këtë gjendje. Në këtë aspekt, aq sa i takon përgjegjësi institucioneve përkatëse të marrin masa aq edhe qytetarët duhet të kenë kujdes maksimal për mos bllokimin e vendeve që janë të dedikuara për lëvizje të këmbësorëve.



Rritja e sasisë dhe cilësisë së ndriçuesve nëpër rrugë:

Ndriçimi i rrugëve të qytetit nënkupton sigurinë më të madhe të shfrytëzuesve të rrugës gjatë natës nga aksidentet, nga qentë endacak apo ndonjë rrezik eventual të mundshëm. Shtimi i ndriçuesve nëpër rrugë nëse është e nevojshme dhe poashtu ndërrimi i atyre të dëmtuara rrit sigurinë në lagje.

Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
- 4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.